

VENDIM
Nr.257, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TJETËR TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “ALDENT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Aldent”, Tiranë, për hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë, në “Stomatologji”, në formën e studimit me kohë të plotë.

2. Kohëzgjatja e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë do të jetë 5 vite. Në përfundim të programit të studimeve lëshohet diploma e integruar e nivelit të dytë (DIND), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Aldent” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Aldent” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Aldent” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha